

2.5. Shitja ose dhënia me qira e pronave dhe aseteve

Për shitjen e pronave në emër të Bashkisë Belsh deri më tani **nuk ka pasur raste**. Për dhënien me qira të aseteve në emër të Bashkisë të tilla si magazinë , ose objekte të ngjashme me to Zyra Juridike bazohet në vendimin nr 54 datë 05/02/2014 "Për përcaktimin e kriterëve , të procedurës e të menyrës së dhënies me qira , enfitoaze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" e gjithë procedura dhe dokumentacioni i nevojshëm përcaktohet në këtë vendim. Për dhënien me qira të tokave bujqësore Bashkia Belsh ka të drejtë të japë me qira vetëm tokat e lira në pronësi të saj dhe që janë ish kooperativa bujqësore, për këtë bazohet në udhezimin nr. 1 datë 18/07/2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara.

Kriteret që duhen plotësuar

Subjektet që kërkojnë të marrin me qera prona paraqesin këto dokumenta:

1. Kërkesën e subjektit për marrjen me qera.
2. Plan-biznesin e hollësishëm.
3. Ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qerasë.
4. Çertifikatën e regjistrimit dhe çertifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKB.
5. NUIS-in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore.
6. Vërtetim nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

1. Propozimin për dhënien me qera të pronës I cili përmban propozimin për veprimtarinë që do të ushtrohet në këtë pronë si dhe afatin e dhënies me qera.
2. Vendimin e organit drejtues të Institucionit (Këshilli Bashkiak).
3. Miratimin e organit në varësi administrative (Prefektura).
4. Genplanin e pasurisë të hartuar nga eksperti topograf i licencuar dhe të konfirmuar nga drejtuesi I institucionit.
5. Tarifën e detyrimit mujor e cila përcaktohet bazuar në VKM-në nr.1064, dt.22.12.2010.
6. Konfirmimin nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme e statusit juridik të pronës.